

V E N D I M
Nr.467 datë 17.8.1993

PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT ME FONDE SHTETËRORE

Me propozimin e Ministrisë së Tregtisë dhe të Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. PËRKUFIZIME

Për qëllime sqaruese të termave të përdorura në këtë vendim:

1. Me "Prokurim" kuptohet veprimtaria e blerjes të çdo lloji, marrje me qira, sipërmarrje investimesh, duke përfshirë edhe shërbimet që lidhen me to.
2. Me "Komision" kuptohet grupi i specialistëve të entit prokurues që realizon procedurën e prokurimit.
3. Me "Ent prokurues" kuptohet subjekti juridik shtetëror a privat që bën prokurimin.
4. Me "Objekt prokurimi" kuptohet objekti i furnizmit, investimit ose shërbimit, i kërkuar nga enti prokurues.
5. Me "Furnizim" kuptohet veprimtaria e sigurimit të lëndëve të para, të prodhimit të gatshëm, të materialeve të ndryshme, të pjesëve të ndërrimit, instrumenteve, pajisjeve e makinerive të çdo lloji etj.
6. Me "Investim" kuptohet çdo lloj veprimtarie që lidhet me ndërtimin, teknologjinë, rindërtimin, shkatërrimin, riparimin ose rinovimin e një objekti ose veprimtari e struktura të tilla, si përgatitja e truallit, gërmimet, hapja e themeleve, përfundimi i godinës, instalime pajisjesh, zbukurime etj.
7. Me "Shërbim" kuptohet kryerje studimi, konsultimi, eksperimentimi, projekti, kërkimi instalimi ose veprimtari të tjera të ngjashme me të.
8. Me "Kontraktues" kuptohen palët që lidhin kontratë.
9. Me "Fond" kuptohet vlera monetare nga Buxheti i Shtetit ose nga kreditë dhe ndihmat shtetërore.
10. Me "Organ që miraton fondin" kuptohet organi qendror a lokal që ka në kompetencë shpërndarjen e fondit.
11. Me "Subjekt publik" kuptohen institucioni buxhetor ose ndërmarrja që subvencionohet nga shteti, të cilët përdorin fondet.
12. Me "Firmë lokale" kuptohet personi fizik dhe juridik shqiptar.

II. RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Vendimi zbatohet për të gjitha rastet kur subjektet publike përdorin fonde.
2. Prokurimi realizohet nga enti i prokurimit sipas procedurave të njësuara në shkall vendi.
3. Prokurimi duhet të garantojë të drejtën e barabartë të subjekteve për të konkurruar, si dhe administrimin e mirë e rigoroz të fondeve të vëna në dispozicion nga organet shtetërore përkatëse.
4. Procedura e prokurimit synon të mos lejojë diskriminime të firmave ose të objektit të prokurimit për shkak të origjinës së tyre.
5. Procedura e prokurimit fillon pas lëshimit të urdhërprokurimit nga titullari i subjektit publik, ku shënohen enti prokurues, objekti i prokurimit, sasia dhe fondi limit i vënë në dispozicion. Fondit limit tejkalohet me miratim me shkrim të titullarit të organit që ka miratuar fondin.
6. Procedurat e prokurimit të këtij vendimi nuk zbatohen në rastet e ndihmave e kredive, për aq sa ato bien në kundërshtim me kushtet dhe marrëveshjet e miratuara me donatorët.

III. ENTI PROKURUES

1. Ent prokurues mund të jetë vetë subjekti publik, një subjekt tjetër publik juridik shtetëror ose privat, i zgjedhur për të realizuar prokurimin sipas kushteve të përcaktuara në këtë vendim.
2. Enti prokurues e realizon prokurimin me anë të një komisioni, i cili përgjigjet për veprimtarinë e tij.
3. Komisioni caktohet nga titullari i entit prokurues dhe përbëhet nga jo më pak se 5 veta, ndër

të cilët rekomandohet zëvendësitullari, drejtuesi i sektorit financiar, juristi dhe jo më pak se dy anëtarë të përhershëm që do të merren me përgatitjen e plotë të dosjes së prokurimit. Në fazën e vlerësimit të ofertave në komision shtohen, me urdhër me shkrim të titullarit të entit prokurues, jo më pak se dy specialistë të kualifikuar të tjerë në funksion të objektit të prokurimit. Anëtarët e përhershëm të komisionit nuk kanë të drejtë vote në fazën e vlerësimit tekniko-ekonomik të ofertave.

4. Asnjë nga anëtarët e komisionit nuk duhet të ketë lidhje legale me konkurruesit. Për këtë qëllim bëhet deklarata me shkrim nga secili anëtar.

5. Drejtuesi dhe anëtarët e përhershëm të komisionit caktohen çdo vit me urdhër me shkrim të titullarit të entit prokurues.

6. Drejtuesi i komisionit zëvendësohet vetëm në raste të veçanta e për arsye objektive dhe për çdo rast me urdhër me shkrim të titullarit të entit prokurues, ku shënohet arsyeja e zëvendësimit.

7. Kontrata me fituesin e ofertës së vlerësuar nga komisioni si më e mira nënshkruhet nga titullari i entit prokurues, ose nga një person tjetër i autorizuar me shkrim prej tij.

8. Për çdo rast komisioni zgjedh dhe zbaton formën e prokurimit që do të përdorë sipas këtij vendimi, duke bërë paraprakisht argumentimin për zgjedhjen e saj, dhe merr miratimin e titullarit të entit prokurues.

9. Subjekti publik, kur prokuron nëpërmjet një enti prokurimi tjetër të specializuar për prokurim, lidh me të kontratë. Enti tjetër prokurues përzgjidhet nga organi që miraton fondin sipas kritereve të përcaktuar e të shpallura prej tij.

IV. FORMAT E KOMUNIKIMIT

1. Njoftimet e entit prokurues mbi objektin e prokurimit, sipas formave, bëhen:

a) Në një buletin zyrtar ose, në mungesë të tij, të paktën në, dy gazeta të mëdha kombëtare dhe në tre numra të njëpasnjëshme të tyre.

b) Në të paktën një organ shtypi të specializuar ndërkombëtar.

c) Ftesë për ofertë e adresuar drejtpërdrejt firmave.

ç) Në përfaqësitë tregtare të Shqipërisë jashtë shtetit.

d) Në përfaqësitë dhe firmat tregtare të huaja në Shqipëri.

Rekomandohen si plotësuese edhe forma të tjera komunikimi, si afishimi, radio, televizioni.

2. Të gjitha komunikimet që bëhen ndërmjet entit prokurues dhe konkurruesve dokumentohen e ruhen.

3. Njoftimet dhe komunikimet bëhen sipas rregullave që përcaktohen në këtë vendim.

4. Njoftimet në organet e mësipërme bëhen në të njëjtën kohë. Mospërputhja në kohë duhet të jetë e argumentuar.

V. FORMAT E PROKURIMIT

A. PROKURIMI ME ANKAND

Prokurimi me ankand është forma më e përgjithshme e prokurimit, e cila garanton konkurrencën e lirë të kandidatëve dhe respekton barazinë ndërmjet tyre. Ankandi mund të jetë:

1. ANKANDI I HAPUR

Ankandi quhet i hapur, kur në të kanë të drejtë të konkurrojnë të gjithë kandidatët që i përgjigjen njoftimit përkatës të bërë nga enti prokurues.

Ankandi i hapur është i detyrueshëm të përdoret, kur fondi për prokurim është mbi 20 milionë lekë, me përjashtim të rasteve kur në këtë vendim parashikohet ndryshe. Ankandi i hapur përdoret edhe kur fondi është nën 20 milionë lekë, nëse nuk argumentohet mundësia e zbatimit të formave të tjera të këtij vendimi.

Ankandi i hapur përdoret për të siguruar ofertën që ofron objektin e prokurimit teknikisht më të mirë dhe me çmimin më të ulët që mund të arrihet nga konkurrenca dhe pjesëmarrja e sa më shumë firmave të ndryshme brenda e jashtë vendit.

2. ANKANDI I KUFIZUAR

Ankandi quhet i kufizuar, kur në të kanë të drejtë të konkurrojnë vetëm kandidatët të zgjedhur e të ftuar nga komisioni, sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim. Numri i kandidatëve caktohet dhe shpallet që në fillim nga komisioni. Numri i kandidatëve që ftohen, nuk duhet të jetë më pak se tre dhe jo më pak se në tre shtete. Si rregull, në ankand ftohen firma prodhuese dhe firma të ndryshme tregtare që tregtojnë objektin e prokurimit të kërkuar.

Ankandi i kufizuar përdoret kur fondi për prokurim është më i vogël se 20 milionë lekë. Ankandi i kufizuar mund të përdoret dhe kur fondi për prokurim është më i madh se 20 milionë lekë, për çdo rast me miratim të organit që miraton fondin, kur objekti i prokurimit mund të realizohet vetëm nga një numër i kufizuar firmash, për shkak të natyrës së tyre specifike teknologjike etj.

B. PROKURIM I DREJTPËRDREJTE

Në prokurimin e drejtpërdrejtë, pavarësisht nga fondi për prokurim, komisioni ka të drejtë të zgjedhë dhe të diskutojë me një kandidat të vetëm dhe mund të marrë vendim. Ky rast tepër i veçantë zbatohet:

a) Për nevoja që mund të plotësohen vetëm nga një markë, patentë, ose e drejtë ekskluzive, të cilën e disponon një kandidat i vetëm, për çdo rast me miratim të organit që e miraton fondin.

b) Për prokurime urgjente, që lidhen me situata tepër të veçanta ekonomike, për të cilat është e pamundur ose jo me interes të zbatohen procedurat e zakonshme, për çdo rast me miratim të Këshillit të Ministrave.

C. PROKURIMI LOKAL

Prokurimi quhet lokal, kur komisioni fton të marrin pjesë në të vetëm firma lokale.

Kjo formë përdoret kur natyra e objektit të prokurimit është e tillë që favorizon realizimin tij nga firma lokale dhe kur plotësohet të paktën njëri nga kushtet e mëposhtme:

a) Çmimet lokale në mënyrë evidente janë më të ulëta se tregu i jashtëm.

b) Lëndët e para, mallrat dhe teknologjia e nevojshme etj. që do të prokurohen, sidomos në rastin e investimeve, disponohen në mënyrë masive brenda vendit, angazhojnë fuqi punëtore e prodhime lokale dhe nuk kërkojnë shpenzime shtesë transporti.

c) Interesa të veçanta ekonomike të vendit justifikojnë kufizimin e pjesëmarrjes vetëm të firmave lokale.

Prokurimi lokal përdoret kur fondi i prokurimit është nën 50 milionë lekë dhe për çdo rast merret miratim nga organi që miraton fondin.

Prokurim lokal mbi këtë vlefë mund të bëhet me miratim të Këshillit të Ministrave.

VI. PROCEDURA E PROKURIMIT

A. PËR TË GJITHA FORMAT

1. Procedura fillon me lëshimin e urdhrit për prokurim (II-5).

2. Duke pasur parasysh formën e prokurimit komisioni përgatit të gjitha dokumentet e duhura për objektin e prokurimit, sipas anekseve përkatëse që i bashkëngjiten këtij vendimi.

3. Dokumentacioni të jetë i shkruar në gjuhën shqipe, me përjashtim të njoftimit që bëhet në shqip e anglisht dhe kontratës në shqip dhe në një gjuhë të huaj.

4. Komisioni përcakton kriteret bazë për vlerësimin e ofertave, të cilat, sipas rastit, lidhen me respektimin e kushteve cilësore e teknike, çmimit më të ulët, kohën dhe kushtet e realizimit, teknologjinë e përdorur, bashkëpunimin me persona fizikë e juridikë vendas, përdorimin e fuqisë punëtore vendase, transferimin e teknologjisë etj.

Kriteret e vlerësimit vendosen dhe shpallen nga komisioni që në fillim të procedurës së prokurimit.

5. Komisioni përcakton kërkesat ndaj firmës, nga të cilat më kryesoret janë:

a) Të zotërojnë e provojë me dokumente aftësi teknike, burime financiare, besueshëri, reputacion të mirë. Në rastet ku veprimtaria e firmës ka nevojë për licencë, ajo duhet ta paraqesë atë.

b) Të ketë zotësi juridike për të lidhur kontratën.

c) Të mos jetë në procesin e falimentimit ose të likuidimit dhe të mos ketë pasuri të hipotekuar që administrohet nga ndonjë gjykatë a zyrë përmbarimi.

ç) Të mos ketë kryer ndonjë vepër penale që lidhet me veprimtarinë e saj, duke përfshirë veprat penale të falsifikimit ose të mashtrimit.

d) Të ketë plotësuar detyrimet ndaj shtetit.

dh) Të deklarojë vlerën e administruar në tri veprimtaritë e fundit.

e) Të deklarojë listën e veprimtarive në dy vjet e fundit.

Pesë kërkesat e para janë përjashtuese, kurse dy të fundit janë vlerësuese.

6. Pas zbatimit të procedurës së zgjedhur dhe përcaktimit të fituesit të ofertës më të mirë, enti prokurues lidh kontratën.

Kushtet e veçanta të kontratës për blerjet, investimet dhe shërbimet përcaktohen me udhëzime

të veçanta të Këshillit të Ministrave.

B. ANKANDI I HAPUR

1. Ankandi i hapur përdoret kur plotësohet kriteri i përcaktuar në (V - A1)
2. Njoftimi për ankandin e hapur bëhet sipas pikave (a), (b) në (IV). Kur komisioni e gjykon të nevojshme, mund të përdorë shtesë edhe rastet e tjera të njoftimeve (d,e) në (IV).
3. Komisioni përgatit dosjen e dokumentacionit të ankandit sipas aneksit 1. Njoftimit i vihet një numër referimi.
4. Afati i fundit i pranimi të ofertave nuk duhet të jetë më pak se 45 ditë nga data e fundit e publikimit të njoftimit. Afati vendoset nga komisioni për çdo rast konkret.
5. Ofertat duhen të paraqiten me një zarf të madh, brenda të cilit futen tri zarfe të vogla. Zarfi i madh duhet të ketë të shkruar në anën e përparme adresën e entit prokurues, numrin e referencës së njoftimit dhe shënimin në shqip e anglisht "të mos hapet para kohës së caktuar". Në tri zarfet e vogla në anën e përparme shënohet emri i konkurruesit, shkruhet origjinal dhe kopje dhe futen nga një kopje të gjithë dokumentet e kërkuara dhe oferta. Nëse zarfi i madh nuk është i vulosur ose nuk ka të shënuar kërkesat e përmendura më sipër, enti prokurues nuk mban përgjegjësi për eliminimin e ofertës.
6. Konkurruesi ka të drejtë të kërkojë sqarime me shkrim për formën dhe përmbajtjen e ofertës që do të paraqesë, si dhe të dokumenteve të tjera që i kërkojnë, deri në 15 ditë para afatit të fundit të pranimi të ofertave. Përgjigjja që i jepet një konkurruesi, u komunikohet për sqarim gjithë konkurruesve të tjerë.
7. Zarfet që mbërrijnë më vonë se data e caktuar, regjistrohen dhe i kthehen menjëherë e të pahapura kandidatit.
8. Për raste të veçanta, për oferta të komplikuar, sipas gjykimit të komisionit, kur parashikohet vështirësi në paraqitjen e ofertës në afatin e caktuar, komisioni mund të vendosë e të shpallë shtyrjen e afatit të fundit të pranimi të ofertave deri në 15 ditë, me kusht që asnjë nga zarfet e mbërritura të mos jetë hapur. Komisioni mund të shtyjë afatin e pranimi të ofertave deri në 15 ditë, edhe kur nuk paraqitet asnjë ofertë. Në rast se edhe në afatin e ri nuk paraqitet ndonjë ofertë, komisioni duhet të përmirësojë dosjen e ankandit dhe të rifillojë procedurën nga e para.
9. Zarfet hapen nga komisioni në ditën, orën dhe vendin e caktuar, të njoftuar që në fillim të procedurës së prokurimit.
10. Në seancën e hapes së zarfave, përveç komisionit, mund të marrin pjesë edhe përfaqësues të kandidatëve që konkurrojnë, dhe përfaqësues të subjektit publik (kur një subjekt publik ka ngarkuar për prokurim një tjetër ent prokurimi).
11. Dosjet shqyrtohen menjëherë ose jo, siç është vendosur e shpallur më parë në njoftim. Shqyrtimi bëhet menjëherë në raste të veçanta, për objekte të thjeshta prokurimi. Në rastin e përgjithshëm komisioni ka në dispozicion kohën e parashikuar që më parë prej tij.
12. Shqyrtimi bëhet në tri faza:
 - a) Faza e parë është shqyrtimi paraprak dhe ka të bëjë me shqyrtimin e dokumenteve, formën e paraqitjes së tyre dhe verifikimin nëpërmjet dokumenteve, nëse firma konkurruese ka garancitë financiare. Kur këto nuk janë në përputhje me rregullat dhe kriteret e shpallura, dosja përjashtohet nga konkurrimi i mëtejshëm. Për këtë fazë përgatitet me shkrim raporti i hapjes së ofertave për gjithë kandidatët.
 - b) Faza e dytë është shqyrtimi teknik, ku bëhet vlerësimi për shkallën e përmbushjes së kërkesave teknike të kërkesë-ofertës nga secili prej kandidatëve.
 - c) Faza e tretë është shqyrtimi ekonomik, ku analizohen çmimet, verifikohen vleftat dhe shqyrtohen shpenzimet.
13. Ofertat e vlerësuara si të rregullta pas shqyrtimit paraprak, krahasohen ndërmjet tyre, sipas vlerësimeve të fazës së dytë e të tretë dhe klasifikohen. Për fazat (b) e (c) përgatitet me shkrim raporti i vlerësimit të ofertave për çdo kandidat. Oferta që konsiderohet më e mirë, shpallet fituese.
14. Komisioni, pas përfundimit të vlerësimit të ofertave dhe përcaktimit të tyre, dërgon materialin përmbledhës për mendim e miratim në organin që miraton fondin.
15. Pas marrjes së miratimit, komisioni : a) shpall fituesin e ofertës më të mirë dhe njofton konkurruesit sipas formës së komunikimit të zbatuar dhe b) fton konkurruesin që ka fituar për lidhje kontrate.
16. Në rast se konkurruesi që ka fituar nuk pranon të lidhë kontratë dhe tërhiqet, kjo dokumentohet dhe shpallet fituese oferta e çmuar si e dyta më e mirë.

17. Dosja e plotë e dokumenteve të prokurimit dhe një kopje e kontratës ruhen nga enti prokurues. Në të nuk lejohen korrigjime dhe mund t'i jepet për shqyrtim vetëm personave që autorizohen nga titullari i entit prokurues.

18. Komisioni mund të anulojë ankandin kur:

- a) Asnjë ofertë nuk kënaq kushtet tekniko-ekonomike të kërkuara.
- b) Të gjitha ofertat përmbajnë parregullsi thelbësore, që e pengojnë shqyrtimin normal të tyre.
- c) Rrethana përjashtimore që nuk mund të parashikoheshin më parë nga komisioni, bëjnë të pamundur kontraktimin. Për këtë njoftohen në të njëjtin organ informacioni të gjithë kandidatët.

C. ANKANDI I KUFIZUAR

1. Zbatohet kur përmbushen kriteret e dhëna në (V-A2).

2. Pasi caktohen konkurruesit, ftesa për paraqitje oferte bëhet sipas pikës (c) në (IV) dhe sipas gjyqimit të komisionit mund të përdoren shtesë edhe pikat (d), (e) të (IV).

3. Ftesa dhe të gjitha dokumentet e ankandit sipas aneksit 2 u dërgohen drejtpërdrejt kandidatëve.

4. Komisioni vazhdon më tej punën për pranimin e ofertave, shqyrtimin, vlerësimin dhe përcaktimin e ofertës më të mirë, lidhjen e kontratës sipas procedurës së përmendur për ankandin e hapur, përveç pikës 14 të (IV-B). Për rastet e veçanta, kur zbatohet ankandi i kufizuar edhe për fondin mbi 200 milionë lekë zbatohet edhe pika 14 të (VI-B).

5. Kur në entin prokurues paraqiten 1-2 oferta, komisioni dhe titullari i entit prokurues gjykojnë nëse duhet të merret vendim për ofertat e paraqitura apo duhet të përsëritet nga fillimi procedura.

D. PROKURIMI I DREJTPËRDREJTË

- 1. Zbatohet kur përmbushen kriteret e dhëna në (V-B).
- 2. Ftesa për prokurimin e drejtpërdrejtë bëhet sipas pikës (c) të (IV).
- 3. Komisioni, pas përcaktimit të konkurruesin, përgatit gjithë dokumentacionin e duhur sipas aneksit 2 dhe ia dërgon drejtpërdrejt atij për paraqitje oferte.
- 4. E gjithë procedura nga çasti i pranimin të ofertës e deri në lidhjen e kontratës, në vartësi nga fondi, është e njëjtë si në ankandin e kufizuar.

E. PROKURIMI LOKAL

- 1. Zbatohet kur përmbushen kriteret e dhëna në (V-C)
- 2. Njoftimi për ankandin e hapur lokal bëhet sipas pikës (a) të (IV).
- 3. Pas paraqitjes së kandidatëve në entin prokurues bëhet regjistrimi i tyre dhe u dorëzohet dokumentacioni i plotë sipas aneksit 2.
- 4. Ofertat e kandidatëve të paregjistruar në entin prokurues janë të pavlefshme.
- 5. Procedura e pranimin të ofertave, shqyrtimit, vlerësimit dhe përcaktimi i ofertës më të mirë, lidhja e kontratës etj. është njëlojtë si në procedurën e ankandit të hapur.

VII. ANKIMI

1. Çdo konkurrues, kur vëren shkelje të procedurave të parashikuara në këtë vendim, ka të drejtën e ankimit.

2. Ankesa i drejtohet titullarit të entit prokurues dhe organit që miraton fondin.

3. Rregullat e ankimit jepen në aneksin 3.

VIII. BLERJET ME SASI E VLEFTA TË VOGLA PA KONTRATË

1. Nga format e mësipërme të prokurimit mund të përjashtohen blerjet e vogla pa kontratë, ku përfshihen:

- a) Shpenzimet për blerjen e artikujve të kancelarisë për nevoja administrative.
- b) Shpenzimet për materiale ndihmëse për riparime të mjediseve administrative.
- c) Shpenzime të vogla për nevoja të prodhimit.
- ç) Shpenzime të tjera të paparashikuara.

2. Për të gjitha rastet e përfshira në pikën (1) fondi total vjetor i shpenzuar për çdo artikull nuk duhet të kalojë vleftën 50 mijë lekë.

3. Pas lëshimit të urdhrin të blerjes nga titullari i subjektit publik, të drejtën për të vendosur për blerjet e vogla pa kontratë e ka komisioni i tij, duke e argumentuar me shkrim dhe për çdo rast vendimin e tij. Komisioni cakton gjithashtu të paktën 2 anëtarë të tij për të realizuar blerjen, të cilët nënshkruajnë edhe faturën e rregullt të blerjes.

4. Dokumentacioni i blerjeve të vogla pa kontratë shqyrtohet nga komisioni të paktën çdo

tremujor. Pas shqyrtimit, kur komisioni vëren blerje të përsëritura të të njëjtit artikull, mund të vendosë që për tremujorët e ardhshëm blerja e këtij artikulli të bëhet njëherësh dhe, kur sasia ose vlefata është e konsiderueshme, blerja të bëhet me kontratë sipas procedurave të prokurimit.

IX. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.191, datë 22.3.1993, pikat 4,5,6, dhe 8 shfuqizohen.

Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr.8, datë 17.8.1993, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

Aneksi 1

ANKANDI I HAPUR

Enti prokurues duhet të përgatitë dokumentacionin përkatës, të nevojshëm për realizimin e ankandit të hapur, i cili përbëhet nga:

DOKUMENTACIONI I ANKANDIT TË HAPUR

1. Njoftimi.
2. Ftesa.
3. Instruksioni për paraqitësit e ofertave.
4. Kusht e përgjithshme të kontratës.
5. Kushtet speciale të kontratës.
6. Tabela përmbledhëse e kërkesave.
7. Dokumenti i angazhimit të plotësimit të detyrimeve kryesore të ofertës dhe tabela e çmimeve
8. Garancia bankare e ofertës.
9. Formulari i kontratës.
10. Specifikimet teknike
11. Garancia e përmbushjes së detyrimeve.

Të dhëna më të hollësishme për dokumentacionin dhe kushtet e kontratës për blerjet, investimet dhe shërbimet caktohen me udhëzim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

Aneksi 2

ANKANDI I KUFIZUAR DOKUMENTACIONI PËR ANKANDIN E KUFIZUAR

Enti prokurues duhet të përgatitë dokumentacionin përkatës, të nevojshëm për realizimin e ankandit të kufizuar, i cili përbëhet nga:

1. Përpilimi i listës së konkurruesve që do të ftohen për të marrë pjesë në paraqitjen e ofertave.
2. Përpilimi i dokumentacionit të ftesës për paraqitje oferte përbëhet nga:
 - Ftesa.
 - Burimi i fondit.
 - Objekti i prokurimit.
 - Adresa e entit prokurues.
 - Instruksioni për paraqitësit e ofertave.
 - Garancia e përmbushjes së detyrimeve dhe garancia bankare e ofertës.
 - Konfirmimi nga firmat për marrjen e ftesës.

3. Përgatitet lista me specifikimet teknike të plota.

Të dhënat të hollësishme për dokumentacionin dhe kushtet e kontratës për blerjet, investimet dhe shërbimet caktohen me udhëzim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

Aneksi 3

ANKIMI

A. E DREJTA E ANKIMIT

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2, çdo konkurrues që deklaron se ka pësuar ose mund të pësojë humbje a dëm, për shkak se komisioni i entit prokurues ka shkelur procedurat e këtij udhëzimi, mund të ankohet në përputhje me rregullat e mëposhtme:

2. Nuk janë objekt ankimi:

a) Zgjedhja e formës së prokurimit.

b) Kufizimi i pjesëmarrjes së firmave në ankand.

c) Vendimi i entit prokurues për të quajtur të pavlefshme të gjitha ofertat e paraqitura.

B. ANKESA NË ENTIN PROKURUES

1. Ankesa i paraqitet me shkrim titullarit të entit prokurues.

2. Titullari i entit prokurues e shqyrton ankesën vetëm kur ajo paraqitet brenda 20 ditëve nga data më e hershme që konkurruesi ka marrë njoftim, ose duhej të kishte marrë dijeni për rrethanat që janë objekt ankimi.

3. Titullari i entit prokurues nuk merr parasysh ankesën pas hyrjes në fuqi të kontratës.

4. Me përjashtim të rasteve kur titullari i entit prokurues dhe ankuesi bien dakord ndërmjet tyre; titullari i entit prokurues pas shqyrtimit të ankesës duhet të bëjë të njohur me shkrim vendimin e tij brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së ankesës. Ky vendim përmban:

a) Argumentimin e veprimit të komisionit, në rast se ankesa nuk quhet e drejtë.

b) Masat korrigjuese, në rast se ankesa quhet tërësisht ose pjesërisht e drejtë.

5. Në rast se titullari i entit prokurues nuk shpall vendimin e tij brenda afatit të mësipërm, ankuesi mund të vazhdojë menjëherë procedurën e ankimit, si në pikën C të këtij kapitulli.

6. Vendimi i titullarit të entit prokurues është përfunduar, me përjashtim të rasteve kur ankuesi vazhdon procedurën e ankimit si në pikën C të këtij kapitulli.

C. ANKESA ADMINISTRATIVE

1. Konkurruesi mund t'i paraqesë ankesë administrative për entin prokurues titullarit të organit që miraton fondin, në rastet kur:

a) Ankesa nuk mund të bëhet sipas pikës (B), sepse kontrata ka hyrë në fuqi (B3). Në këtë rast ankesa shqyrtohet vetëm nëse paraqitet brenda 20 ditëve nga data më e hershme që konkurruesi ka marrë dijeni, ose duhej të kishte marrë dijeni për rrethanat që janë objekt ankimi.

b) Zbatohet pika (B5), por jo më vonë se 20 ditë nga mbarimi i afatit të parashikuar në pikën (B4).

c) Ankuesi, pasi njihet me vendimin e titullarit të entit prokurues në përgjigje të ankesës që ka bërë sipas pikës (B), nuk bie dakord me vendimin. Në këtë rast ankesa duhet të paraqitet jo më vonë se 20 ditë nga shpallja e vendimit të titullarit të entit prokurues.

2. Me marrjen e ankesës, organi që miraton fondin njofton entin prokurues.

3. Titullari i organit që miraton fondin, pasi shqyrton ankesën, bën të njohur me shkrim vendimin e tij brenda 30 ditëve nga paraqitja e ankesës. Ky vendim përmban:

a) Argumentimin e veprimit të entit prokurues, në rast se ankesa nuk quhet e drejtë.

b) Masat korrigjuese, në rast se ankesa quhet tërësisht ose pjesërisht e drejtë.

4. Titullari i organit që miraton fondin, ka të drejtë:

a) Të ndalojë entin prokurues të ndërmarrë një veprim ose të marrë një vendim që është në kundërshtim me rregullat e procedurat e këtij udhëzimi.

b) Të detyrojë entin prokurues, që ka ndërmarrë një veprim ose një vendim që është në kundërshtim me rregullat e procedurat e këtij udhëzimi, që të veprojë ose vendosë në përputhje me udhëzimin.

c) Të anulojë tërësisht ose pjesërisht një veprim a vendim në kundërshtim me rregullat e

procedurat e këtij udhëzimi, me përjashtim të veprimeve dhe vendimeve që kanë sjellë hyrjen në fuqi të kontratës ose vetë kontratën.

ç) Të korrigjojë një vendim që është në kundërshtim me rregullat e procedurat e këtij udhëzimi ose ta zëvendësojë atë me vendimin e tij, me përjashtim të veprimeve që kanë sjellë hyrjen në fuqi të kontratës ose vetë kontratën.

d) Të urdhërojë ndërprerjen e procedurës së prokurimit.

5. Vendimi i titullarit të organit që shpërndan fondin është përfundimtar.

D. RREGULLA TË TJERA

1. Pas marrjes së një ankese, sipas pikave (B) dhe (C), përkatësisht titullari i entit prokurues dhe i organit që miraton fondin, ve në dijeni konkurruesit me të cilët ka lidhje ankesa.

2. Çdo konkurrues ose organizëm shtetëror, interesat e të cilit cenohen ose mund të cenohen nga ankesa, ka të drejtë të marrë pjesë në procedurën e shqyrtimit të saj. Në rast se nuk merr pjesë në këtë procedurë, nuk ka të drejtë që më pas të bëjë ankese të të njëjtit lloj.

3. Një kopje e vendimit të titullarit i dërgohet, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit, ankuesit dhe konkurruesve ose organizmave shtetërorë që kanë marrë pjesë në procedurën e shqyrtimit të ankesës. Ankesa dhe përgjigjja vihen gjithashtu në dispozicion të publikimit, me kusht që të mos përmbajë të dhëna, të cilat cenojnë interesa të palëve që mbrohen me ligj.

E. NDËRPRERJA E PROCEDURËS SË PROKURIMIT

1. Pas marrjes së ankesës sipas pikave (B) dhe (C), titullari përkatës mund të ndërpresë deri në 7 ditë procedurën e prokurimit, kur bindet që vazhdimi i procedurës i sjell ankuesit dëme të pariparueshme, është e dukshme se ankuesi ka të drejtë dhe ndërprerja e procedurës nuk dëmton interesat e palëve të tjera.

Në këtë rast me ndërprerje procedure nënkuptohet edhe shtyrja e datës së hyrjes në fuqi të kontratës.

2. Titullari përkatës mund të zgjatë periudhën e ndërprerjes së procedurës së prokurimit edhe deri në 30 ditë, me qëllim që të mbrojë të drejtat e ankuesit, me përjashtim të rastit kur komisioni vërteton me shkrim domosdoshmërinë e vazhdimit të procedurës për shkaqe urgjente të interesit të përgjithshëm.

3. Çdo vendim i marrë në kuadrin e pikave (1) dhe (2) ruhet në dosjen e prokurimit.